



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4656/16, për z. Lulzim Paçarizi, Menaxher në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Lulzim Paçarizi, Menaxher në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Paçarizi është njoftuar se zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Prandaj, Agjencia kundër Korrupsionit i ka kërkuar zyrtarit të lartë të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do ti bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur këtë situatë.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/149/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat N.SH "TAKU EKS - L".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

